www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 151

Tiranë – E enjte, 11 gusht 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 82/2016 datë 25.7.2016	Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.....	11701
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 27.7.2016	Për disa shtesa në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave", të ndryshuar.....	11701
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 27.7.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 662, datë 8.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Kuçovë", të ndryshuar.....	11704
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 27.7.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 946, datë 2.9.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Krumë, të qarkut të Kukësit"	11705
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 27.7.2016	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë të pronës me sipërfaqe 371 m^2 truall, pjesë e pronës me nr. 17, me emërtimin "Rezidenca Qeveritare Vlorë", dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të ndryshuar.....	11710

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 27.7.2016	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "*Recovered Earth Albania*" sh.a., si qiramarrës, për pasurinë "Truall dhe objekt të pasurisë nr. 603/3, ZK 2111, vol. 2, f. 171, Kasnicë, Fier", të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., Patos.....	11712
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 27.7.2016	Për caktimin e gjashtë anëtarëve në përbërje të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, të përzgjedhur me konkurrim publik.....	11716
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 27.7.2016	Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide.....	11716
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 558, datë 27.7.2016	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Ruzhdie, Bashkia Patos, të qarkut të Fierit.....	11717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 27.7.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 44, datë 27.1.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kushovë, të qarkut të Elbasanit".....	11718
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 29.7.2016	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Kavajë, të pronës nr. 365, me emërtim "Ish-bateria ABD", me vendndodhje në Kalanë e Turrës, Synej, Kavajë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	11719
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 29.7.2016	Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.....	11724
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 562, datë 29.7.2016	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Bomira" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Truall dhe objekt (rrënoja)", pjesë e pronës nr. 1018, ish-venddislokimi i Shtabit të Vjetër të Bazës Ajrore Kuçovë, Berat, të Ministrisë së Mbrojtjes.....	11724
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 29.7.2016	Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese që preken nga ndërtimet informale.....	11729
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 29.7.2016	Për ngarkimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për llogari të Autoritetit të Aviacionit Civil.....	11735
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4320, datë 29.7.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1, shtesat, pjesa lindore", Vlorë.....	11736

Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4321, datë 29.7.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i i rrugës "Dhimitër Konomi", në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë".....	11737
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4322, datë 29.7.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi dhe sistemimi i rrugës "Gjykata – Akademia e Marinës" + rruga "Duro Shaska" deri te 7 pallatet, Vlorë, faza I.....	11738
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4323, datë 29.7.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i bulevardit "Jakov Xoxa", Fier".....	11742

LIGJ
Nr. 82/2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja "d", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 55, paragrafi i dytë, i ndryshuar me ligjin nr. 135/2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"", shfuqizohet.

Neni 2

Neni 278 riformulohet si më poshtë:

"Neni 278
Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit

Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyese ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Mbajtja e armëve shpërthyese ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, tregtimi dhe transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i armëve shpërthyese, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Po kjo vepër e parashikuar nga paragrafi i pestë i këtij neni, kur kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Falsifikimi ose fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave mbi armët dhe municionet luftarake dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet"."

Neni 3

Në nenin 279, paragrafi i dytë, fjalët "dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet" zëvendësohen me fjalët "dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet".

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9717, datë 8.8.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 538, datë 27.7.2016

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pronat sipas formularëve, gjithsej 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Identefikoi : Eugen Nako, Titullar i ASHV Fier(Lushnje),

Jonida Lika, Specialiste Arkiviste e ASHV Fier

Supervizoi: Arben Dervishllari, Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Aprovoi: Gjet Ndoj, Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Arkivi Shtetëror Vendor Fier

Fusha e përdorimit të Pronës: Infrastuktur

Nr Rend	A			B			C				
	Zona kadastr& Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip Totale e pronës(m2)	Nga Sip Totale: Sa Ndërtesë(m2)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Eoti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Entl përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8571 & Ind. Hart. LU-K-7	18/29	Ndërtesë 3 (tre) katëshe	Lagja " Kongresi i Lushnjes", Bashkia Lushnje	1236 m2	457 m2	Arkiv Shtetëror Vendor	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Arkivi Shtetëror Vendor Fier me Qëndër Lushnje	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Identifikoi: Eridan NdreuTitullar i ASHV Gjirokaster, Martin Zeko, Vergjeni Lena
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Arben Dëmyshllari Drejtor i Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Gjet Ndoj Drejtor i Pergjithshem i Arkivave
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Drejtoria e Pergjitheshme e Arkivave
ASHV Gjirokaster
Fusha e perdorimit te Prones: Infrastrukture

Nr. Rend.	A			B			C				
	Zona Kadastr. & indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Se Mjaftese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Ne dhenia-terfera (Shenime te veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1	8542 GJ - H -7	2/128	Godine + Truall	Rr. "Doktor Vasil Laboviti" Lgj. Varrosh. Gjirokaster	774 m2	275 m2	Arkivi Shteteror Vendor Gjirokaster	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	Arkivi Shteteror Vendor Gjirokaster		

VENDIM
Nr. 539, datë 27.7.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 662, DATË 8.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË BASHKISË KUÇOVË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "d", 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, miratuar me vendimin nr. 662, datë 8.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Shtohen pronat me numrat rendorë 568, 569 dhe 570 në pronësi të Bashkisë Kuçovë, me destinacion kënd lojërash, gjithsej 1 (një) fletë, sipas lidhjes 1 dhe formularit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) Përmasat e pronës me numër rendor 402, me destinacion "fushë tenisi", zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Bashkisë Kuçovë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronave të përcaktuara në pikën 1.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Bashkia Kuçovë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FORMULAR PËR INVETARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Bashkia Kuçovë

Identifikoi: **Edmond Menaj** (Specialiste),
Xhenisa Kostreni(Specialiste).
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: **Ferdinand Putro**
(Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimi)
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: **Selfo Kapllani** (Kryetar i Bashkisë Kuçovë)
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KUÇOVË

Fusha e përdorimit: Shtesa 1

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Nr rendor	Zona Kadastrale Indeksi i hartës	Nr pasurise	Lloji i prones	Emri i prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m^2)	Nga Sip Totale: Sa ndertese (m^2)	Funksioni per te cilen perdoret prona	Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/ Enti perdorues, Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
568	2310 F-5	7/148	Lulishte	Truall Lgj nr 1, blloku "Tafil Skëndo" Bashkia Kuçovë	2186.3	-	Kënd lojërash për fëmijë	Bashkia Kuçovë	Bashkia Kuçovë	
569	2310 F-5	7/149	Rrugë	Truall Lgj nr 1, blloku "Tafil Skëndo" Bashkia Kuçovë	217.2	-	Kënd lojërash për fëmijë	Bashkia Kuçovë	Bashkia Kuçovë	
570	2310 F-5	7/150	Park	Truall Lgj nr 1, blloku "Tafil Skëndo" Bashkia Kuçovë	3022.7	-	Kënd lojërash për fëmijë	Bashkia Kuçovë	Bashkia Kuçovë	

FORMULAR PËR INVETARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Bashkia Kuçovë

Identifikoi: **Edmond Menaj** (Specialiste),
Xhenisa Kostreni (Specialiste).
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: **Ferdinand Putro**
(Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimi)
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: **Selfo Kapllani** (Kryetar i Bashkisë Kuçovë)
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)

Fusha e përdorimit: Kulture

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Numri rendor	Indeksi i hartes Zona Kadastrale	Numri i pasurise	Lloji i prones	Emri i prones Adresa	Siperfaqe Totale e Prones (m²)	Siperfaqe ndertese (m²)	Funksioni per te cilen perdoret prona	Enti me pergjegjesi administrative	Enti perdorues, Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera
402	F-5 2310	7/102	Fushe sporti	Fusha e Tenisit Lagja nr 1, blloku "11 Shkurti" B Kuçovë	1243	95	Kulture sport	Bashkia Kuçovë	Bashkia Kuçovë	

VENDIM
Nr. 540, datë 27.7.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 946, DATË 2.9.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KRUMË, TË QARKUT TË KUKËSIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 946, datë 2.9.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në titullin e vendimit, fjalët "… të bashkisë Krumë …" zëvendësohen me "… të njësisë administrative Krumë, Bashkia Has …".

b) Në listën e inventarit, bashkëlidhur këtij vendimi, shtohen pronat me numrat rendorë 365–424 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë – katërqind e njëzet e katër) për Bashkinë Has, njësia administrative Krumë, gjithsej 4 (katër) fletë, sipas lidhjes 1 dhe formularëve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Has për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

BASHKIA HAS PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KRUMË

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
367–374, 377–397, 400–409, 411–418, 420–422	Insfarstrukturë (trotuare, sheshe, rrugë, terrene sportive brenda bashkisë)	Në pronësi
365, 366, 375, 376, 398, 399, 410, 419, 423, 242	Troje brenda territorit te bashkisë	Në përdorim

5. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa ne teresi)

Identifikoi: Rakip Çela Inspektor Pronash
(emri, Mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Novruz Bardhoshi Pergj. Zyres Planifikim dhe Zhvillimit Urban
(emri, Mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Adem Lala Kryetari I Bashkisë
(emri, Mbiemri, pozicioni zyrtar, Tel., firma, Vula)

Bashkia: **HAS**

Njesia Administrative Krume

Fusha e perdorimit te prones: **Infrastrukture (Troje dhe hapsira publike)**

	A		B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastrale. Indeksi Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja/shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te prones	Adresa/vend ndodhja e komponentev e perbere	Permasat e prones ne m^2 ose ml	Fuksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Stutusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
365	2282 KR - D - 3	4/192	Trull , Bashkia Has		Lagja nr. 2	1349	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
366	2282 KR - D - 3	4/29	Trull , Bashkia Has		Lagja nr. 2	582	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
367	2282 KR - D - 3	4/209	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr. 2	1583	SHESH+LULISHTE	Bashkia Has	Bashkia Has	
368	2282 KR - D - 3	4/210	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr. 2	604	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
369	2282 KR - D - 3	4/191	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr. 2	604	SHESH+LULISHTE	Bashkia Has	Bashkia Has	
370	2282 KR - D - 3	4/38	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr. 2	743	SHESH+LULISHTE	Bashkia Has	Bashkia Has	
371	2282 KR - D - 3	4/212	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.2	62	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
372	2282 KR - D - 3	4/35	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr. 2	712	Rruge+lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
373	2282 KR - D - 3	4/38	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.2	743	Rruge+lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
374	2282 KR - D - 3	4/213	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.2	510	Rruge+lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
375	2282 KR - C - 4	4/179	Trull , Bashkia Has		Lagja nr.2	3644	Hapsira Publike	Bashkia Has	Bashkia Has	

376	2282 KR - C - 4	4/205	Trull , Bashkia Has		Lagja nr.2	534	Hapsira Publike	Bashkia Has	Bashkia Has	
377	2282 KR - C - 3	4/223	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	155	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
378	2282 KR - D - 4	4/171	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.2	1026	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
379	2282 KR - D - 4	4/225	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	104	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
380	2282 KR - D - 4	4/78	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.2	3557	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
381	2282 KR - D - 4	4/57	Terren Sportiv, Bashkia Has		Lagja nr.2	3557	Terren Sportiv	Bashkia Has	Bashkia Has	
382	2282 KR - D - 4	4/114	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.2	760	Hapsira Publike	Bashkia Has	Bashkia Has	
383	2282 KR - D - 4	4/79	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	172	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
384	2282 KR - D - 4	4/100	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	95	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
385	2282 KR - D - 4	4/102	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	154	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
386	2282 KR - D - 4	4/103	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	105	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
387	2282 KR - D - 4	4/109	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	175	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
388	2282 KR - D - 4	5/47	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	495	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
389	2282 KR - D - 4	5/49	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	317	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
390	2282 KR - D - 4	5/52	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	423	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
391	2282 KR - D - 4	5/77	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	406	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
392	2282 KR - D - 4	5/55	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	217	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
393	2282 KR - D - 4	5/65	Shesh , Bashkia Has		Lagja nr.1	259	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
394	2282 KR - D - 3	5/66	Rruge, Bashkia Has		Lagjia nr.1	169	Rruge	Bashkia Has	Bashkia Has	

395	2282 KR - D - 3	5/67	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	257	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
396	2282 KR - D - 4	5/345	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	81	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
397	2282 KR - D - 3	5/273	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	296	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
398	2282 KR - D - 3	5/11	Truall, Bashkia Has		Lagjia nr.2	561	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
399	2282 KR - D - 3	5/214	Truall, Bashkia Has		Lagjia nr.2	1313	Rruge+lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
400	2282 KR - D - 3	5/19	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	191	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
401	2282 KR - D - 3	5/7	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	126	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
402	2282 KR - D - 3	5/30	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	93	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
403	2282 KR - D - 3	5/29	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	297	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
404	2282 KR - D - 3	5/32	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	295	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
405	2282 KR - D - 3	5/28	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	207	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
406	2282 KR - D - 3	5/209	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	689	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
407	2282 KR - D - 3	5/340	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	303	SHESH+LULISHTE	Bashkia Has	Bashkia Has	
408	2282 KR - D - 3	5/34	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	252	SHESH	Bashkia Has	Bashkia Has	
409	2282 KR - D - 3	5/258	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	935	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
410	2282 KR - D - 3	5/5	Truall, Bashkia Has		Lagjia nr.2	208	Shesh	Bashkia Has	Bashkia Has	
411	2282 KR - D - 3	5/22	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	1372	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
412	2282 KR - D - 3	5/25	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	585	Shesh + Rruge	Bashkia Has	Bashkia Has	
413	2282 KR - D - 3	5/26	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	334	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	

414	2282 KR - D - 3	5/170	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	118	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
415	2282 KR - D - 3	5/171	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	27	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
416	2282 KR - D - 3	5/172	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.2	120	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
417	2282 KR - D - 3	5/169	Rruge, Bashkia Has		Lagjia nr.2	116	Rruge	Bashkia Has	Bashkia Has	
418	2282 KR - D - 3	5/83	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	154	Shesh	Bashkia Has	Bashkia Has	
419	2282 KR - E - 4	5/248	Truall, Bashkia Has		Lagjia nr.1	411	Shesh	Bashkia Has	Bashkia Has	
420	2282 KR - E - 4	5/349	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	243	Lulishte	Bashkia Has	Bashkia Has	
421	2282 KR - D - 4	5/60	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	162	Shesh	Bashkia Has	Bashkia Has	
422	2282 KR - D - 3	5/299	Shesh , Bashkia Has		Lagjia nr.1	271	SHESH+LULISHTE	Bashkia Has	Bashkia Has	
423	2282 KR - D - 4	5/351	Truall, Bashkia Has		Lagjia nr.1	46	Shesh	Bashkia Has	Bashkia Has	
424	2282 KR - D - 4	5/43	Truall, Bashkia Has		Lagjia nr.1	166	Shesh	Bashkia Has	Bashkia Has	

Mbyllet me nr.rendore 424

Shenim: *Siperfaqja dhe numri I pasurise edhe munde te ndryshojne pasi Zona Kadastrale nr.2282 Qyteti Krumë është ne procesin e Regjistrimit Fillestar.*

Konfirmohet Z.V.R.P.P. Has

VENDIM
Nr. 541, datë 27.7.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË VLORË TË PRONËS ME SIPËRFAQE 371 m^2 TRUALL, PJESË E PRONËS ME NR. 17, ME EMËRTIMIN "REZIDENCA QEVERITARE VLORË", DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja "f", 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë të sipërfaqes 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m^2 truall, pjesë e pronës me nr. 17, me emërtimin "Rezidenca Qeveritare Vlorë", sipas planimetrisë bashkëlidhur, me qëllim ndërtimin e rrugës "Dhimitër Konomi", Vlorë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të hiqet prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Bashkisë Vlorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Bashkia Vlorë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


PLAN VENDOSJA E OBJEKTIT
53CH 1390.000m
64CH 1600.000m
Gjatesia: 210 m
Siperfaqja: 371m2
Distanca nga muri ekzistues: 1m - 2.5m

VENDIM
Nr. 545, datë 27.7.2016

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "RECOVERED EARTH ALBANIA" SHA, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË "TRUALL DHE OBJEKT TË PASURISË NR. 603/3, ZK 2111, VOL. 2, F. 171, KASNICË, FIER", TË SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA, PATOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "*Recovered Earth Albania*" sh.a., si qiramarrës, për pasurinë "Truall dhe objekt të pasurisë nr. 603/3, ZK 2111, vol. 2, f. 171, Kasnicë, Fier", në pronësi të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., Patos, me sipërfaqe të përgjithshme, sipas genplanit, 50 753 (pesëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) m^2, nga ku sipërfaqe nën objekt është 343 (treqind e dyzet e tre) m^2 dhe sipërfaqe funksionale është 50 410 (pesëdhjetë mijë e katërqind e dhjetë) m^2, sipas kontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Republika e Shqipërisë
Zyra e Noterisë Tiranë
Nr. ____Rep.
Nr.____ Kol.

DRAFTKONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata
Lidhur

Në Tiranë, sot më datë _____të muajit _____ të vitit 2016 (dy mijë e gjashtëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit_____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përfaqësuar me ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Milva Ekonomi, e datëlindjes __.__.19__, banuese në Tiranë, me shtetësi shqiptare, e pajisur me letërnjoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet "Qiradhënësi"

DHE

Shoqëria "Recovered Earth Albania" sh.a., me seli qendrore në Tiranë dhe me adresë: Njësia Bashkiake nr. 2, sheshi "Italia", hotel "Sheraton", kati II, zyra 9, Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKR me NIPT: L61318002T, përfaqësuar nga z. _____, i datëlindjes ___.___.19___, lindur në _____, me shtetësi _____, identifikuar me _____ Nr. _____, _____, që më poshtë do të quhet "Qiramarrësi".

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera

të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. _____, datë ___.___.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata", ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si Qiradhënës dhe shoqërisë "Recovered Earth Albania" sh.a. si qiramarrës, për pasurinë "Truall dhe objekte", Kasnicë, Fier, në pronësi të "Albpetrol" sh.a. dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, si dhe kërkesës së shoqërisë "Recovered Earth Albania" sh.a., në datën 28.6.2016, së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore "Truall dhe objekt të pasurisë nr. 603/3, ZK 2111, vol. 2, f. 171, Kasnicë, Fier", në pronësi të "Albpetrol" sh.a., Patos me sipërfaqe të përgjithshme me sipërfaqe të përgjithshme, sipas genplanit, 50 753 (pesëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) m^2, nga ku sipërfaqe nën objekt është 343 (treqind e dyzet e tre) m^2 dhe sipërfaqe funksionale është 50 410 (pesëdhjetë mijë e katërqind e dhjetë) m^2, sipas certifikatës së pronësisë datë 29.12.2014 të ZVRPP-së Fier.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për ushtrimin e aktiviteteve ekonomike me qëllim kryerjen e investimeve në aktivitet përpunues dhe prodhues në fushën e hidrokarbureve, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me firmosjen e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 Qiradhënësi, nëpërmjet shoqërisë "Albpetrol" sh.a., si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e Qiramarrësit.

4.3 Qiradhënësi është i detyruar të garantojë Qiramarrësin për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.4 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 60 ditë përpara me shkrim.

4.5 Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 Qiramarrësi ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 Qiramarrësi ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar për mjedisin dhe konventat ndërkombëtare për mjedisin në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

5.3 Qiramarrësi detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planbiznesin e paraqitur në konkurrim.

5.4 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin, objekt i kësaj kontrate, detyrohet që brenda 3 viteve ushtrimore, duke filluar nga marrja e lejes së ndërtimit, do të investojë në ndërtimin e një impianti, të përbërë nga 4 linja prodhimi dhe përpunimi të rërës bituminoze, në vlerën totale 3 801 132 327 lekë (tre miliardë e tetëqind e një milion e njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e shtatë), sipas parashikimit për investimet dhe fazat e zhvillimit të tij, të shprehura në planbiznesin e paraqitur, që janë si vijon:

Faza e parë. Gjatë fazës së parë të investimit do të konsistojë në përshtatjen e pasurisë shtetërore të marrë me qira në funksion të qëllimit, si dhe vendosjen e makinerisë së parë të linjës së prodhimit. Investimi total i fazës së parë do të jetë në vlerën 382 000 000 (treqind e tetëdhjetë e dy milionë) lekë dhe do të realizohet brenda vitit 2016.

Faza e dytë. Gjatë fazës së dytë të investimit, parashikohet të përfundojnë punimet dhe përgatitjet deri në instalimin e plotë të linjës së prodhimit kundrejt një investimi në vlerën prej 3 267 000 000 (tre miliardë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë) lekësh. Ky investim do të realizohet brenda vitit 2017.

Faza e tretë. Gjatë fazës së tretë të investimit parashikohet të përfundojë ndërtimi i impiantit. Investimi total i fazës së tretë do të jetë në vlerën 152 132 327 (njëqind e pesëdhjetë e dy milionë e njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë dhe do të realizohet brenda vitit 2018.

5.5 Qiramarrësi, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në planbiznesin e paraqitur në konkurrim, detyrohet që, në objektin e marrë me qira, brenda vitit 2018 do të ketë të punësuar 360 punonjës (treqind e gjashtëdhjetë), nga data e marrjes në dorëzim të objektit. Punësimi do të realizohet në tri faza. Në përfundim të vitit 2016 do të ketë punësuar 50 (pesëdhjetë) punonjës. Në përfundim të vitit 2017 do të ketë të punësuar dhe 130 (njëqind e tridhjetë) punonjës dhe në përfundim të vitit 2018 do të ketë të punësuar edhe 180 (njëqind e tetëdhjetë) punonjës të tjerë.

5.6 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.4 dhe 5.5, detyrohet që të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.7 Qiramarrësi detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira, sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e planbiznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.4 dhe 5.5 të kësaj kontrate.

5.8 Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te Qiradhënësi në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.9 Qiramarrësi detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.10 Qiramarrësi, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga Qiramarrësi.

5.11 Në ngarkim të Qiramarrësit janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

Neni 6

Pagesa e qirasë

6.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë Qiradhënësit detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës Qiramarrësi ka paguar garancinë e kontratës në vlerën 76 022 647 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë, sipas faturës së lëshuar nga Qiradhënësi, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të vlerës së plotë të investimit të shprehur në nenin 5.4 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoba dhe kamatëvonesa), Qiramarrësi do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e Qiradhënësit, sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur Qiramarrësi, në përfundim të vitit 2018, nuk ka realizuar vlerën e investimeve të përcaktuara në pikën 5.4 të kësaj kontrate, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, Qiradhënësi zgjidh kontratën dhe gjobit Qiramarrësin, me vlerën e garancisë së ngurtësuar në atë moment.

7.2 Në rastin kur Qiramarrësi, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.5 të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune të pahapur.

Neni 8
Përgjegjësitë e palëve

8.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

8.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të çdo faze për investimin, pas relacionit të paraqitur nga Qiramarrësi, sipas pikave 5.4, 5.5 dhe 5.7 të kësaj kontrate, palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, shoqërisë "Albpetrol" sh.a., Patos dhe Qiramarrësit, për nivelin e investimeve të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë, shoqëruara me relacionin përkatës, të hartuar nga eksperti kontabël i autorizuar, si dhe realizimin e numrin e të punësuarve, vërtetuar me dokumentacion nga institucionet përgjegjëse.

8.3 Palët, Qiramarrësi dhe shoqëria "Albpetrol" sh.a., Patos, janë të detyruara që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, lidhur me ruajtjen e nivelit të punësimit, investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

8.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

8.5 Qiramarrësi përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 9
Zgjidhja e kontratës

9.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

9.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;

c) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate;

d) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5.6 të kësaj kontrate.

9.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 60 ditë pas njoftimit me shkrim të Qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse Qiramarrësi nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 10
Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë te nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Përfaqësuar nga
Milva Ekonomi

QIRAMARRËSI
Shoqëria "Recovered Earth Albania"

Përfaqësuar nga

VENDIM
Nr. 547, datë 27.7.2016

PËR CAKTIMIN E GJASHTË ANËTARËVE NË PËRBËRJE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, TË PËRZGJEDHUR ME KONKURRIM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 29, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, të përzgjedhur me konkurrim publik, si më poshtë vijon:

a) Z. Tomi Treska;
b) Znj. Ana Lalaj;
c) Znj. Kseanela Sotirofski;
ç) Znj. Brikena Baxhaku;
d) Znj. Elida Reçi;
dh) Znj. Suzana Tabaku.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Këshilli Kombëtar për Arsimin Parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 553, datë 27.7.2016

PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË AUTORIZIMIT TË PRODUKTEVE BIOCIDE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 14, të ligjit nr. 95/2015, "Për shërbimet dhe produktet biocide", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide, me këtë përbërje:

a) Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë — kryetar;
b) Një përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor — anëtar;
c) Një përfaqësues nga Instituti i Shëndetit Publik — anëtar;
ç) Një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit — anëtar;
d) Një specialist të kualifikuar, në një nga fushat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 95/2015, të përzgjedhur nga ministri i Shëndetësisë — anëtar.

Të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", në pikën 1, të këtij vendimi, duhet të kenë kualifikimin e përcaktuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 95/2015.

2. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide, në varësi të problematikës që do të shqyrtohet në mbledhje, thërret ekspertë edhe nga fusha të tjera.

3. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide është organ teknik, këshillimor, i cili:

a) mbështet autoritetin kompetent për hartimin e politikave për shërbimin biocid në shëndetin publik;

b) rekomandon, sipas rastit, lëshimin apo refuzimin e aktit të autorizimit dhe vendosjen në treg të produkteve biocide;

c) rekomandon ndalimin apo kufizimin e përdorimit të produkteve biocide;

ç) rekomandon përcaktimin e formulimit kuadër të produkteve biocide.

4. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi në fushën e produkteve biocide. Ata, paraprakisht, duhet të deklarojnë marrëdhëniet, nëse kanë, me subjektet e importimit ose të tregtimit të produkteve biocide.

5. Sekretariati i Autorizimit të Produkteve Biocide është edhe sekretariat i Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide. Përbërja e tij përcaktohet nga ministri i Shëndetësisë, brenda strukturës dhe organikës së Ministrisë së Shëndetësisë.

6. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide, si rregull, mblidhet një herë në 2 (dy) muaj, sipas njoftimit të kryetarit, dhe mbledhjet zhvillohen me jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Njoftimi, ku përcaktohen rendi i ditës dhe materialet që do të diskutohen në mbledhje, u dërgohet anëtarëve të komisionit, të paktën, 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

7. Vendimet për dhënien e rekomandimeve për autoritetin kompetent merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

8. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide thirret nga kryetari. Kur një anëtar nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi, përjashtohet, me vendim të kryetarit të Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide dhe zëvendësohet nga institucioni përkatës.

9. Mbledhjet e Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide drejtohen nga kryetari dhe, në mungesë të tij, vetë kryetari cakton një anëtar të komisionit për drejtimin e mbledhjes.

10. Procesverbali për çdo mbledhje mbahet nga personi i caktuar nga Sekretariati i Autorizimit të Produkteve Biocide, i cili merr pjesë rregullisht në çdo mbledhje të zhvilluar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 558, datë 27.7.2016

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE RUZHDIE, BASHKIA PATOS, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të njësisë administrative përbërëse Ruzhdie, të Bashkisë Patos, që transferohen në pronësi ose në përdorim të saj, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij

Lista e inventarit të njësisë administrative Ruzhdie përbëhet nga 54 (pesëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rendor 865 (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Patos dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Njësia Admistratrative Ruzhdie Bashkia Patos Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
14-18, 18/1	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
19-25	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
43-45	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
26,27,27/1,27/2,27/3,27/4, 28,28/1, 29-42,	Varrezat publike	Në pronësi
407-596,733-743,855-865	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
46-239, 241-299	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
300-406, 597-646	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi

VENDIM
Nr. 559, datë 27.7.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 44, DATË 27.1.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KUSHOVË, TË QARKUT TË ELBASANIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 44, datë 27.1.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në titullin e vendimit, fjalët "… të komunës Kushovë …" zëvendësohen me "… të njësisë administrative Kushovë, Bashkia Gramsh …".

b) Në listën e inventarit, pronës me numër rendor 95 t'i ndryshojë emërtimi dhe sipërfaqja, sipas formularit bashkëlidhur, gjithsej, 1 (një) fletë.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Gramsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Identifikoi: Dhurata Çimo (Specialiste e Aseteve) nr,cel .069 64 85 329 ose 0675298198
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Bashkia Gramsh / Njesia / Administrative: Kushove : Supervizoi: Manjola Çekrezi (Angjensia e Inventarit te Territorit
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Fusha e perdorimit te Prones : Zhvillim ekonomik Aprovoi: Luljeta Dollani (Kryetare Bashkise)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

Nr. Rend	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi ligjor i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
95	1272 151-C	120/14	truall ndertese	ish shkolle Fshati Bregas Njesia Admnistrative Kushove Bashkia Gramsh	300	87	Zhvillim ekonomik	Njesia administrative Kushove Bashkia Gramsh	Njesia administrative Kushove Bashkia Gramsh	Objekti eshte jasht funksionit mbas verefikimi ne terren te prones prona me nr pasurie 120/14 të hiqet si emertim gabine elektrike dhe dhe të vendoset ish shkolle .Per te vazhduar proçeduren për korigjim te lista perfundimtare te inventarit per Njesin Administrative Kushove . Korgjimi tëbehet Sipas listes se invenarit nr .rendor ,95 faqe 17.

VENDIM
Nr. 560, datë 29.7.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA KAVAJË, TË PRONËS NR. 365, ME EMËRTIM "ISH-BATERIA ABD", ME VENDNDODHJE NË KALANË E TURRËS, SYNEJ, KAVAJË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Kavajë, të pronës nr. 365, me emërtim "Ish-bateria ABD", me vendndodhje në Kalanë e Turrës, Synej, Kavajë, sipas formularit standard të inventarizimit dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ta përdorur për realizimin e projektit për ndërtimin e portit turistik të jahteve, në Kalanë e Turrës, Synej, Kavajë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 365, me emërtim "Ish-bateria ABD", me vendndodhje në Kalanë e Turrës, Synej, Kavajë, e cila i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i janë transferuar në pronësi apo në përdorim Bashkisë Kavajë.

3. Bashkisë Kavajë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, objekteve dhe të truallit funksional, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Kavajë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe

kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

MINISTRIA E MBROJTJES **Identifikoi** : Roland **Llazari** Shef DTPP; ARBEN **SULO** Drejtori i DMPM.

Komuna Synej, Kavajë **Supervizoi** : N/Kol. Vasil **Lelaj,** Shef Sektori J3/7; N/Kol.Jetmir **Balla,** OF/Shtabi J3/7;

Fusha e përdorimit të pronës : N/Kol. Aurora **Matoshi,** Specialiste J-4, Major Petrit **Sade** Specialist J-6.

Për Mbrojtjen Kombëtare **Aprovoi** : Kolonel VLADIMIR **AVDIAJ,** Drejtor i Drejtorisë Operacionale dhe Stërvitjes.

	A		B				C				
Nr	Zona Kadast Indeksi i hartes	Numëri pasuris	Emërtesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e Pronës në **M2** ose **MI**	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me Përgjegjësi Administrative	Enti Përdorues Statusi Juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
365	**ZK Nr.2909 Çert Datë 01.12.04**	**Nr. 219/1 Pas**	**Ish Bateria ABD**		Kala e Turrës, Synej, Kavajë	**600139.54 M2**	Për Mbrojtjen	Ministria Mbrojtjes Rep. Usht. Nr.2001(KFD) Durrës	Reparti Ushtarak Nr.2230 Durrës	- Identifikuar me të dhënat e formularit standart dhe të planvendosjes, të dërguar nga KFD, me Nr.2708/8, dat 03.12.2010
				Mencë Kuzhinë		60.5				
				Kabinë elektrike		12.2				
				Depo		176.3				
				Depo		46.5				
				WC		(4)				
				Park depo		388.6				Rrënuar
				Dushe WC		29.6				
				Depo furrë buke		75.5				
				Depo armatimi		70.2				

				Fjetinë		199.1							
				Depo qymyri		(7)							
				Zyra klase		324.6							
				Lavanteri		67.8							
				Bankinë		243							
				Truall		599694							
367	**ZK Nr.2909 Çert Datë 10.03.05**	**Nr. 219/3 Pas**	**Hidrografia**		Kala e Turrës, Synej, Kavajë	**200 M2**	Për Mbrojtjen	Ministria Mbrojtjes Rep. Usht. Nr.2001(KFD) Durrës	Reparti Ushtarak Nr.2230 Durrës	- Identifikuar me të dhënat e formularit standart dhe të planvendosjes, të dërguar nga KFD, me Nr.2708/8, datë 03.12.2010.			
				Feneri		12.5							
				Truall		187.5							


PLAN-VENDOSJA E PRONS Nr. 365 "BATERIA ABD" KALAJA E TURRËS KAVAJË
PRONA 365
Deti Adriatik
Deti Adriatik
FENER
rrugë
bankine
pz
SHPJEGUESE:
SISTEMI I KOORDINATAVE SHTETËRORE
558 550
568 300
558 050
557 800
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DURRËS


Maj 2016
SHK. 1:5000
Zv/DREJTOR I IGJIU
Ark. Enea SINOIMERI
Rihartoi
Topograf Ramiz Haxhiu
SHPJEGUESE:
SIP. E PËRGJITHËSHME E REP = 600139.56 m2
SIP. NËN OBJEKTE = 1443.36 m2
KUFIRI I REPARTIT
- Nga azhornimi i kryer më dt.13.06.2014 nga grupi punës i përbërë përfaqësuesi i F.D dhe i I.GJ.U rezultoi se në pronen nr.365 objektet ishin te gjitha rrënoja përjashtuar objektin nr.1 dhe bankina.
- Kjo Plan-vendosje u hartua në zbatim të shkresës me nr.2092 dt.19.05.2016 të Komandës të Forcës Detare dhe bazuar në Planvendosjen e marrë nga arkivi i IGJIU hartuar në Qershor 2014.
Deti Adriatik
FENER
bankine
rruge
pz
pz
pz
1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
558 050
557 800
557 550
557 300
369 750
369 500
369 250
369 000
370 000

VENDIM
Nr. 561, datë 29.7.2016

PËR STANDARDIZIMIN DHE DISIPLINIMIN E SHPENZIMEVE TË KARBURANTIT NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 562, datë 29.7.2016

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "BOMIRA" SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË "TRUALL DHE OBJEKT (RRËNOJA)", PJESË E PRONËS NR. 1018, ISH-VENDDISLOKIMI I SHTABIT TË VJETËR TË BAZËS AJRORE KUÇOVË, BERAT, TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Bomira" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Truall dhe objekt (rrënoja)", pjesë e pronës nr. 1018, ish-venddislokimi i Shtabit të Vjetër të Bazës Ajrore Kuçovë, Berat, në administrim të Komandës së Forcave Ajrore, Ministria e Mbrojtjes, me sipërfaqe të përgjithshme, sipas genplanit, prej 42 009 (dyzet e dy mijë e nëntë) m^2, nga të cilat sipërfaqe ndërtimi 2 115.41 (dy mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë pikë dyzet e një) m^2 dhe sipërfaqe funksionale 39 893.59 (tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) m^2, sipas tekstit të kontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Republika e Shqipërisë
Zyra e Noterisë Tiranë
Nr. ____Rep.
Nr.____ Kol.

PROJEKTKONTRATË QIRAJE
Me tarifën simbolike 1 euro/kontrata
Lidhur

Në Tiranë, sot në datën _____të muajit _____ të vitit 2016 (dy mijë e gjashtëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit_____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përfaqësuar me ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Milva Ekonomi, e datëlindjes __.__.19__, banuese në Tiranë, me shtetësi shqiptare, e pajisur me letërnjoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet "Qiradhënësi"

DHE

Shoqëria "Bomira" sh.p.k., me seli qendrore në Berat, Ura Vajgurore dhe me adresë: rruga "Antipatrea", lagjja "18 Tetori", godina 2-katëshe nr. 20, Zona Kadastrale 3682, me nr. pasurie 1/463, Berat, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT: K02701016D, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Ylli Aliaj, i biri i _____, i datëlindjes 8.2.1961, lindur në Kapaj, Fier dhe banues në _____, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin personal me nr. G10208230R, që më poshtë do të quhet "Qiramarrësi".

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. _____, datë_____2016 të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata", ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si Qiradhënës dhe shoqërisë "Bomira" sh.p.k. si Qiramarrës, për pasurinë "Truall dhe objekte (rrënoja)", pjesë e pronës nr. 1018 ish-venddislokimi i Shtabit të Vjetër të Bazës Ajrore Kuçovë, Berat, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, së bashku me Qiramarrësin, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore "Truall dhe objekte (rrënoja)" pjesë e pronës nr. 1018 ish-venddislokimi i Shtabit të Vjetër të Bazës Ajrore Kuçovë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes me sipërfaqe të përgjithshme, sipas genplanit, 42 009 m^2, nga ku sipërfaqe ndërtimore: 2 115.41 m^2 dhe sipërfaqe funksionale: 39 893.59 m^2.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për ngritjen e një qendre multifunksionale, për grumbullimin, seleksionimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin të frutave e perimeve të freskëta, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës për fermerët e zonës dhe përreth zonës.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhe 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me firmosjen e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 Qiradhënësi, nëpërmjet Komandës së Forcave Ajrore (strukturë në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura), si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e Qiramarrësit.

4.3 Qiradhënësi është i detyruar të garantojë Qiramarrësin për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.4 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 60 ditë përpara me shkrim.

4.5 Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 Qiramarrësi ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 Qiramarrësi ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar për mjedisin dhe ushqimin.

5.3 Qiramarrësi detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas afatit dhe vlerave të shprehura në planbiznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë, në sistemimin e ambienteve ekzistuese, në ndërtimin e një qendre multifunksionale, për grumbullimin, seleksionimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin e frutave dhe perimeve të freskëta, një vlerë totale prej 210 000 000 (dyqind e dhjetë milionë) lekësh, i cili do të realizohet brenda vitit 2018. Sipas planbiznesit të paraqitur, në konkurrim, ky investim do të realizohet si vijon:

Së pari, do të investojë për ndërtimin e qendrës së integruar të grumbullimit (vendosja e qendrës logjistike), vjelja-selektimi-paketimi-ruajtja-marketingu-shitja (eksport dhe tregu i brendshëm).

Së dyti, do të realizohet ngritja e qendrës së shërbimit për fermerët (mbështetje me inpute, materiale gjenetike për prodhime sasiore dhe cilësore sipas kërkesave të tregut), laborator dhe qendër trajnimi.

5.5 Qiramarrësi, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në planbiznesin e paraqitur në konkurrim, detyrohet që, në objektin e marrë me qira, deri në fund të vitit 2017 nga data e marrjes në dorëzim të objektit do të ketë punësuar 20 (njëzet) punonjës dhe, në fund të vitit 2018 do të ketë punësuar 50 (pesëdhjetë) punonjës, periudhë që përkon me periudhën e përfundimit të investimit.

5.6 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.4 dhe 5.5, detyrohet që, të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.7 Qiramarrësi, detyrohet që në pasurinë e marrë me qira të respektojë kushtet e dhënies me qira të vendosura nga Komanda e Forcave të Armatosura (strukturë në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura), si njësia administruese dhe monitoruese, si vijon:

- Prona kthehet menjëherë nëse i nevojitet FARSH-së në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë;
- Respektimin e standardeve të NATO-s dhe të ICAO-së, për sipërfaqen ndërtimore dhe lartësitë e lejuara (deri në 7.5 m), për këtë zonë;
- Mosndryshimi i destinacionit për të cilin jepet me qira;
- Respektimi i akteve ligjore dhe normave që janë në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

5.8 Qiramarrësi detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira, sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e planbiznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.4 dhe 5.5 të kësaj kontrate.

5.9 Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te Qiradhënësi në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.10 Qiramarrësi detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.11 Qiramarrësi, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga Qiramarrësi.

5.12 Në ngarkim të Qiramarrësit janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

Neni 6

Pagesa e qirasë

6.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë Qiradhënësit detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës Qiramarrësi ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 4 200 000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë, sipas faturës së lëshuar nga Qiradhënësi, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.4 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoba dhe kamatëvonesa), Qiramarrësi do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e Qiradhënësit, sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

Penalitetet

7.1 Në rastin kur Qiramarrësi, në përfundim të vitit 2018, nuk ka realizuar investimet e përcaktuara në pikën 5.4 të kësaj kontrate, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, Qiradhënësi zgjidh kontratën dhe gjobit Qiramarrësin, me vlerën e garancisë së ngurtësuar në atë moment.

7.2 Në rastin kur Qiramarrësi, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.5 të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune të pahapur.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;

c) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate;

d) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5.6 dhe 5.7 të kësaj kontrate;

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 60 ditë pas njoftimit me shkrim të Qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse Qiramarrësi nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9

Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga Qiramarrësi, sipas pikave 5.4, 5.5 dhe 5.6 të kësaj kontrate, palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Komandës së Forcave Ajrore (strukturë në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura) dhe Qiramarrësit, për nivelin e investimeve dhe të punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël.

9.3 Palët, Qiramarrësi dhe Komanda e Forcave Ajrore (strukturë në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura) janë të detyruara që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 Qiramarrësi përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10

Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe procesverbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë te nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

QIRAMARRËSI
Shoqëria "Bomira" sh.p.k.
Përfaqësuar nga
Z. Ylli Aliaj

VENDIM
Nr. 563, datë 29.7.2016

PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, PËR SIPËRFAQET TAKUESE QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3, të nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja "c", dhe 5, pika 2, të ligjit nr. 10239, datë 25.2.2010, "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në qarqet e Tiranës, Elbasanit, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës.

2. Sipërfaqja që shpronësohet është 20 354,9 (njëzet mijë e treqind e pesëdhjetë e katër presje nëntë) m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit është 427 670 242,65 (katërqind e njëzet e shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e dy presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në formatin tabela nr. 1.

3. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, Elbasan, Vlorë, Durrës dhe Shkodër, të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive te Paluajtshme dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela 1

LISTA EMËRORE E SUBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE TË KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPËRBLIMIT

NR. I BASHKËPRONARËVE	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	NR. I PRONAVE	QARKU	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	SIPËRFAQJA TAKUESE PËR KOMPENSIM	VLERA E TREGUT PËR TRUALL (lekë/m²)	VLERA E SHPËRBLIMIT (lekë)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
TIRANË										
1	DIELLI		SHEHU	1	TIRANË	8340	8/622	124	30,158	3,739,592.00
2	HANA		SINA (Shehu)							
3	LAURETA		SEREZI (Shehu)							
4	LUMTURI		KUÇI (Shehu)							
5	TEUTA		URUÇI (Shehu)							
6	VIOLETA		TOPI (Shehu)							
7	YLLI		SHEHU							
8	SHAZIE	HASAN	SARACI	2	TIRANË	8120	8/487	42.70	29,106	1,242,826.20
9	XHEVDET	HASAN	DURMISHI							
10	EDMOND	VIKTOR	KOKA	3	TIRANË	8190	11/1170	363.00	33,755	12,253,065.00
11	ASTRIT	MAHMUT	VATHI	4	TIRANË	8120	9/443	495.40	29,106	14,419,112.40
12	BARDHYL	MUSTAFA	VATHI							
13	BASHKIM	OSMAN	VATHI							
14	BEHIJE	MAHMUT	VATHI							
15	BLEDAR	MAHMUT	VATHI							
16	DHURATA	MAHMUT	VATHI							
17	ELTON	BUJAR	VATHI							
18	EMINE	MAHMUT	VATHI							
19	FITNETE		VATHI							
20	GANI	OSMAN	VATHI							
21	GENC	MAHMUT	VATHI							
22	LIRI	MUSTAFA	VATHI							

23	MUSA	OSMAN	VATHI							
24	NETIJE	OSMAN	VATHI							
25	OSMAN	MUSTAFA	VATHI							
26	REXHEP	OSMAN	VATHI							
27	SABRIJE		VATHI							
28	SEMIHA	MAHMUT	VATHI							
29	SOKOL	MAHMUT	VATHI							
30	SULLTANE	OSMAN	VATHI							
31	SIRI	TAHIR	BESHIRI	5	TIRANË	8120	9/121	4.60	29,106	133,887.60
32	ESAT	TAHIR	BESHIRI							
33	LUTFIJE	TAHIR	DIZDARI							
34	HILMIJE	TAHIR	HAMZARAJ							
35	NJAZI	HYSEN	BESHIRI							
36	LIRI	JUSUF	KABA							
37	XHILDA	JUSUF	KOKA							
38	SAIR	JUSUF	PREZA							
39	NURI	ISUF	BESHIRI							
40	LEJLA		BESHIRI							
41	AIDA	ESHREF	GALANXHI							
42	MIRANDA	ESHREF	FERRA							
43	LINDITA	EJUP	HASHORVA							
44	SEMIRAMIZ	EJUP	KRAJKA							
45	HAMET	ISUF	RUSTEMAJ							
46	ARTEMONA	HAMET	RUSTEMAJ							
47	EDUARD	HAMET	RUSTEMAJ							
48	ANITA	HAMET	ROKO							
49	SELAUDIN	ABDYL	SHARRA							
50	ZANA	ABDYL	PUSTINA							
51	SIRI	TAHIR	BESHIRI	6	TIRANË	8120	9/119	257	29,106	7,480,242.00
52	ESAT	TAHIR	BESHIRI							
53	LUTFIJE	TAHIR	DIZDARI							
54	HILMIJE	TAHIR	HAMZARAJ							
55	NJAZI	HYSEN	BESHIRI							
56	LIRI	JUSUF	KABA							
57	XHILDA	JUSUF	KOKA							
58	SAIR	JUSUF	PREZA							
59	NURI	ISUF	BESHIRI							
60	LEJLA		BESHIRI							
61	AIDA	ESHREF	GALANXHI							
62	MIRANDA	ESHREF	FERRA							
63	LINDITA	EJUP	HASHORVA							
64	SEMIRAMIZ	EJUP	KRAJKA							
65	HAMET	ISUF	RUSTEMAJ							
66	ARTEMONA	HAMET	RUSTEMAJ							
67	EDUARD	HAMET	RUSTEMAJ							
68	ANITA	HAMET	ROKO							
69	SELAUDIN	ABDYL	SHARRA							
70	ZANA	ABDYL	PUSTINA							
71	SEMIHA	BEQIR	BONJAKU (qoqja)	7	TIRANË	8340	4/328	1,228.20	30,158	37,040,055.60
72	BUKURIJE		LEKAJ (Qoqja)							
73	SHQIPE	BEQIR	MEÇA (Qoqja)							
74	FATOS	BEQIR	QOQJA							
75	SADIK	BEQIR	QOQJA							
76	LUTFIE		KAZAZI							
77	BAJRAM	QAZIM	ÇERKEZI	8	TIRANË	8340	4/292	53.80	30,158	1,622,500.40
78	ENKELEJDA		MECE	9	TIRANË	8340	4/329	142.40	30,158	4,294,499.20
79	MAKBULE	SELIM	HUTA	10	TIRANË	8330	6/557	23.40	34,068	797,191.20
80	BUJAR	KADRI	MUÇA	11	TIRANË	3321	11/19	234.10	2,560	599,296
81	DILAVER	RAMAZAN	YLLI	12	TIRANË	8230	3/164	673.00	23,703	15,952,119.00
82	ENKLI	HALIM	YLLI							
83	SHPRESA	ZENEL	YLLI							
84	GERAND	HALIM	YLLI							
85	MEDIHA	RAMAZAN	LLAGAMI							
86	DHURATA	RAMAZAN	MYFTIU							
87	ISLAM	TEOFIK	GJINALI							
88	ESMA	TEOFIK	KARAPICI							
89	AIDA	TEOFIK	GJINALI							
90	ALIJE	HASAN	YLLI							
91	ERISA	IRFAN	YLLI							
92	DONALD	IRFAN	YLLI							
93	HASAN		BEKA	13	TIRANË	8110	5/300	88	23,703	2,085,864.00
94	BUJAR		BEKA							
95	HYSEN		BEKA							
96	EQEREM		BASHA	14	TIRANË	8110	5/499	217.10	23,703	5,145,921.30
97	SHPETIM		NDROQI							
98	AHMET		BASHA							
99	LUAN		BASHA							
100	AFERDITA		BASHA							
101	LULEZIM		BASHA							
102	SKENDER		BASHA							

103	NEKI		MYDERIZI							
104	FUAT		MYDERIZI							
105	SILVANA		MYDERIZI							
106	ADRIANA		MYDERIZI							
107	HATIXHE		KRUETANI							
108	NEDRET		MYFTIU							
109	SPARTAK		MYFTIU							
110	TEUTA		MYFTIU							
111	SUZANA		MYFTIU							
112	ABDULLA		MYFTIU							
113	AHMET		MYFTIU							
114	GJYLE		BASHA							
115	QEMAL		BASHA							
116	MUHAMET		BASHA							
117	RIZA		BASHA							
118	ENGJELLUSHE		KOKONOZI							
119	LAVDIE		KOKONOZI							
120	LULJETA		KOKONOZI							
121	MIMOZA		KOKONOZI							
122	LEJLA		KOKONOZI							
123	YLBER		KOKONOZI							
124	EMINE		BASHA							
125	AGIM		BASHA							
126	BEQIR		HUSHA	15	TIRANË	8120	8/556	345.20	29,106	10,047,391.20
127	FERIDE		HUSHA							
128	HATLIJE		ILJAZI							
129	MIRUSHE		RECI							
130	RUKIJE		PLUMBI (Husha)							
131	SHEFQET		HUSHA							
132	BEQIR		HUSHA	16	TIRANË	8120	8/560	286.20	29,106	8,330,137.20
133	FERIDE		HUSHA							
134	HATLIJE		ILJAZI							
135	MIRUSHE		RECI							
136	RUKIJE		PLUMBI (Husha)							
137	SHEFQET		HUSHA							
138	BAKUSHE	ABDULLA	BODINAKU	17	TIRANË	8120	8/473	220.40	29,106	6,414,962.40
139	BEDRIJE	ABDULLA	LIÇI							
140	HYRIJE	ABDULLA	DUKA							
141	NURIJE	ABDULLA	MEZINI							
142	QAMILE	ABDULLA	LAÇI							
143	SEMIHA	ABDULLA	HUQI							
144	SHYQYRI	ABDULLA	DERHEMI							
145	BAKUSHE	ABDULLA	BODINAKU	18	TIRANË	8120	8/474	43.90	29,106	1,277,753.40
146	BEDRIJE		BODINAKU							
147	HYRIJE	ABDULLA	DUKA							
148	NURIJE	ABDULLA	MEZINI							
149	QAMILE	ABDULLA	LAÇI							
150	SEMIHA	ABDULLA	HUQI							
151	SHYQYRI	ABDULLA	DERHEMI							
152	BAKUSHE	ABDULLA	BODINAKU	19	TIRANË	8120	8/471	240.50	29,106.00	6,999,993.00
153	BEDRIJE	ABDULLA	LIÇI							
154	HYRIJE	ABDULLA	DUKA							
155	NURIJE	ABDULLA	MEZINI							
156	QAMILE	ABDULLA	LAÇI							
157	SEMIHA	ABDULLA	HUQI							
158	SHYQYRI	ABDULLA	DERHEMI							
159	BAKUSHE		DRIZA	20	TIRANË	8120	8/898	301	29,106.00	8,760,906.00
160	LUAN		DRIZA							
161	MEHMET		DRIZA							
162	AFERDITA		LUNAKU	21	TIRANË	8120	8/427	484.40	29,106	14,098,946.40
163	INSAN		BANKA							
164	LUMNIE		PAJA							
165	MYNEVERE		ZAMBAKU							
166	RIZVAN		BANKA							
167	SARA		TARTARI							
168	VILDAN		BANKA							
169	VJOLLCA		LLAGAMI							
170	BAKUSHE	ABDULLA	BODINAKU	22	TIRANË	8120	8/470	224.9	29,106	6,545,939.40
171	BEDRIJE	ABDULLA	LIÇI							
172	HYRIJE	ABDULLA	DUKA							
173	NURIJE	ABDULLA	MEZINI							
174	QAMILE	ABDULLA	LAÇI							
175	SEMIHA	ABDULLA	HUQI							
176	SHYQYRI	ABDULLA	DERHEMI							
177	AFERDITA		LUNAKU	23	TIRANË	8120	8/426	442.20	29,106	12,870,673.20
178	IHSAN		BANKA							
179	LUMNIE		PAJA							
180	MINAVERE		ZAMBAKU							
181	RIZVAN		BANKA							
182	SARA		TARTARI							
183	VILDAN		BANKA							

184	VJOLLCA		LLAGAMI							
185	GEZIM	HYSEN	GRORI	24	TIRANË	8120	8/916	1,065.80	29,106	31,021,174.80
186	GEZIM	HYSEN	GRORI	25	TIRANË	8120	8/563	330.3	29,106	9,613,711.80
187	FAHRI	QAZIM	ALLUSHI	26	TIRANË	8120	8/456	5.90	29,106	171,725.40
188	ISMETE		SKERA	27	TIRANË	8120	8/503	283	29,106	8,236,998.00
189	SIRI	TAHIR	BESHIRI							
190	ESAT	TAHIR	BESHIRI							
191	LUTFIJE	TAHIR	DIZDARI							
192	NILMIJE	TAHIR	HAMZARAJ							
193	NJAZI	HYSEN	BESHIRI							
194	LIRI	JUSUF	KABA							
195	XHILDA	JUSUF	KOKA							
196	SAIR	JUSUF	PREZA							
197	NURI	ISUF	BESHIRI							
198	LEJLA		BESHIRI							
199	AIDA	ESHREF	GALANXHI	28	TIRANË	8120	8/401	307	29,106	8,935,542.00
200	MIRANDA	ESHREF	FERRA							
201	LINDITA	EJUP	HASHORVA							
202	SEMIRAMIZ	EJUP	KRAJKA							
203	HAMET	ISUF	RUSTEMAJ							
204	ARTEMONA	HAMET	RUSTEMAJ							
205	EDUARD	HAMET	RUSTEMAJ							
206	ANITA	HAMET	ROKO							
207	SELAUDIN	ABDYL	SHARRA							
208	ZANA	ABDYL	PUSTINA							
209	SIRI	TAHIR	BESHIRI							
210	ESAT	TAHIR	BESHIRI							
211	LUTFIJE	TAHIR	DIZDARI							
212	NILMIJE	TAHIR	HAMZARAJ							
213	NJAZI	HYSEN	BESHIRI							
214	LIRI	JUSUF	KABA							
215	XHILDA	JUSUF	KOKA							
216	SAIR	JUSUF	PREZA							
217	NURI	ISUF	BESHIRI							
218	LEJLA		BESHIRI							
219	AIDA	ESHREF	GALANXHI	29	TIRANË	8120	8/304	213	29,106.00	6,199,578.00
220	MIRANDA	ESHREF	FERRA							
221	LINDITA	EJUP	HASHORVA							
222	SEMIRAMIZ	EJUP	KRAJKA							
223	HAMET	ISUF	RUSTEMAJ							
224	ARTEMONA	HAMET	RUSTEMAJ							
225	EDUARD	HAMET	RUSTEMAJ							
226	ANITA	HAMET	ROKO							
227	SELAUDIN	ABDYL	SHARRA							
228	ZANA	ABDYL	PUSTINA							
229	ANILA		WITONSKI							
230	ARBEN		RAMAJ							
231	ARTA		TAFARUCI							
232	DHURATA		HOXHA							
233	DYLFIQARE		TUFINA							
234	IGLI	EMIN	HOXHA							
